

Modeli ekonomik I Shqipërisë

Një studim gjithëpërfshirës i themeleve ekonomike,
varësisë nga flukset e paligjshme, pasojat dhe zgjidhjet.



**Albanian
Conservative Institute**

Instituti Konservator Shqiptar
Tiranë, 2025

Përmbajtja

Përkufizimi i një narkoshteti dhe situata në Shqipëri	2
Ekonomia Shqiptare: Karakteristikat, Tiparet dhe Faktorët që e Mbajnë në Këmbë.....	11
Rekomandime.....	18
Veprime në afatshkurtër kundër karteleve dhe krimit të organizuar	18
Burime	22

Përkufizimi i një narkoshteti dhe situata në Shqipëri

Në peizazhin e ekonomive evropiane në zhvillim, Shqipëria paraqet një paradoks të qëndrueshmërisë së dukshme mes një brishtësie të thellë. Kjo analizë nxjerr në pah një ekonomi gjithnjë e më të përfshirë në rrjetin e aktiviteteve të paligjshme, veçanërisht trafikun e drogës, një model i paqëndrueshëm në afat të mesëm dhe të gjatë.

Duhet të theksojmë që në fillim se qëllimi ynë nuk është ta paraqesim vendin tonë në një dritë negative. Përkundrazi, të shtyrë nga elementë shqetësues në ekonominë shqiptare, si ekspertë synojmë të ofrojmë një panoramë të plotë të ekonomisë dhe një vizion të ri, së bashku me rekomandime konkrete politike, që do ta shpëtojnë atë dhe do ta përgatisin vendin për integrimin evropian.

Shqipëria, një vend anëtar i NATO-s, ndodhet përballë një katastrofe demografike, me rreth 1.1 milion qytetarë që kanë braktisur vendin, ligjërisht dhe në mënyrë të paligjshme drejt zonës Shengen, sipas EUROSTAT. Të dhënat demografike të OKB-së dhe institucioneve evropiane tregojnë se Shqipëria po përjeton një nga rëniet më të shpejta të lindshmërisë në botë dhe ndër më të rëndat në Evropë. Në gjysmën e parë të vitit 2025, rënia e lindjeve të reja ishte 6.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në nëntë muajt e parë të vitit 2025, lindjet ishin 4.6% më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Viti 2024 shënoi një rënie prej 5% krahasuar me vitin 2023. Viti 2021 ishte viti i parë i regjistruar ku numri i lindjeve vjetore (27,211) ishte më i ulët se numri i vdekjeve (30,507). Edhe në gjysmën e parë të vitit 2025, shtesa natyrore ishte sërish negative. Nga një prej popullsive më të reja në Evropë, Shqipëria po shndërrohet në një komb në shuarje, gjë që na shqetëson thellësisht si studiues.

Shqipëria në vitet e fundit është etiketuar gjithnjë e më shpesh si një “narkoshtet” ose si një vend me “narkoekonomi” nga media kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nga ekspertë të huaj, një term që përshkruan një shtet ku trafiku i drogës ndikon ndjeshëm në ekonomi, politikë dhe institucione.

The Independent (2019) e përshkruan Shqipërinë si “qendra e trafikut të drogës në Evropë”, duke theksuar rolin e saj në prodhimin e kanabisit dhe tranzitin e kokainës. Në mënyrë të ngjashme, Proto Thema (2019) e quan atë “narkoshteti i parë i Evropës”, duke treguar shtrirjen e krimit të organizuar. BBC (2024) e përforcon këtë perceptim duke e quajtur Shqipërinë “kryeqyteti i marijuanës në Evropë”, duke cituar dominimin e saj në furnizimin rajonal me kanabis.

Këto karakterizime burojnë nga pozicioni strategjik i Shqipërisë në Adriatik, institucionet e dobëta pas komunizmit dhe korrupsioni i përhapur, siç theksohet edhe nga The Guardian (2019), i cili detajoi rrjetet globale të kokainës të mafies shqiptare. Arrestimet, si dhe raportimet nga media si Telegraph, tregojnë sasi të konsiderueshme kokaine që transportohen përmes portit kryesor të Shqipërisë dhe shuma marramendëse parash të përfshira, duke vërtetuar raportimet e mëparshme mediatike dhe institucionale.

Nëse nuk specifikohet ndryshe, ky studim përdor PBB-në nominale të Shqipërisë sipas INSTAT dhe Bankës Botërore, të konvertuar në euro sipas kursit mesatar vjetor të këmbimit për vitin përkatës. PBB-ja nominale vlerësohet rreth 27 miliardë euro në vitin 2024 dhe projektohet në rreth 29.9 miliardë euro për vitin 2025.

Ky etiketim pasqyron një realitet të dyfishtë: një ekonomi formale me një PBB prej 27 miliardë eurosh në vitin 2024 dhe të projektuar rreth 29.9 miliardë euro në vitin 2025, si dhe një ekonomi informale që vlerësohet në 30–35% të PBB-së (rreth 8–9.5 miliardë euro). Kjo bie në kontrast të fortë me mesataren e BE-së për ekonominë informale, e cila është rreth 10%, duke nënvizuar statusin e jashtëzakonshëm të

Shqipërisë në Evropë. Si ekspertë të politikave publike, ne synojmë të studiojmë se çfarë pjese e kësaj ekonomie informale buron nga aktiviteti i paligjshëm dhe cilat janë pasojat..

Ndikimi ekonomik i tregtisë së drogës

Shkalla e tregtisë së drogës është e konsiderueshme, duke formuar një rrymë të errët që mban gjallë ekonominë e dukshme ndërsa gërryen themelet e saj. Media dhe raportimet investigative kanë cituar shifra të xhiros bruto për trafikun e kanabisit dhe kokainës, të lidhura me rrjete kriminale shqiptare, që arrijnë disa miliardë euro në vit. Këto shifra përfaqësojnë vlerësime maksimale të vlerës totale të tregut dhe jo pjesën që përthithet apo qarkullon brenda ekonomisë shqiptare. Për këtë arsye, ky studim nuk fokusohet në xhiron bruto kriminale, por në kanalet e vëzhgueshme makroekonomike të transmetimit: presionet mbi kursin e këmbimit, boshllëqet në financimin e ndërtimit, çekuilibrat tregtarë dhe deformimet sektoriale, të cilat tregojnë një përthithje të konsiderueshme, por të pa llogaritshme saktësisht, të të ardhurave të paligjshme.

Sipas UNODC, Shqipëria është shndërruar vitet e fundit në një nga vendet kryesore tranzit për trafikun e heroinës dhe kokainës, me lidhje me vendet e Amerikës Latine, prej nga droga shkon drejt vendeve të Bashkimit Evropian, Amerikës Latine ose SHBA-së.

Në vitin 2022, i njëjti raport përmendi Shqipërinë si një nga vendet kryesore për kultivimin e kanabisit, e shtata në botë dhe e para në rajonin e Evropës Juglindore. Raporti e përshkruan Shqipërinë edhe si pikë tranziti për heroinën që nis nga Pakistani, kalon nëpër Siri, Turqi, Greqi, Shqipëri dhe më pas drejt vendeve të Evropës Perëndimore.

Këto flukse e deformojnë ekonominë dhe sjellin pasoja jashtëzakonisht serioze për mirëqenien e çdo qytetari, jo vetëm për shkak të deformimit aktual të ekonomisë, por edhe për atë që do të ndodhë më pas, në momentin kur rubineti i parave të pista të mbyllet. The Guardian (2019) dhe Insider (2023) raportojnë se fitimet nga droga pastrohen përmes sektorit të ndërtimit, duke nxitur një rritje prej 6.8% në këtë sektor.

CityAM (2023) vëren se “kullat që shkëlqejnë” në Tiranë pasqyrojnë këtë kapital të paligjshëm, me rreth 20% të fondeve të ndërtimit (rreth 0.36 miliardë dollarë) që janë informale. Turizmi gjithashtu përfiton në mënyrë indirekte, por industria përpunuese, ndoshta sektori më i rëndësishëm, e cila ka rënë nga 11% e PBB-së në vitin 2015 në 9% në vitin 2023, vuan nga neglizhenca.

Raportimi i CityAM thekson se: “edhe pse standardet e jetesës janë përmirësuar ndjeshëm që prej asaj kohe, dështimi për t’u shndërruar në një ekonomi të vërtetë tregu i ka dhënë pushtet bosëve të drogës dhe ka detyruar më të mirët dhe më të aftët të emigrojnë. Sigurisht, nuk ka shifra zyrtare, por vendi tashmë përmendet si ‘Kolumbia e Evropës’. Vlerësimet sugjerojnë se nga një e treta deri në gjysmën e produktit kombëtar bruto të Shqipërisë vjen nga trafiku i drogës. Në çdo rast, disa miliardë euro gjenerohen çdo vit nga trafiku i drogës.”¹

Përkufizimi i një narkoshteti

Sipas fjalorit Collins, një narkoshtet është një vend në të cilin tregtia e paligjshme e narkotikëve përbën një pjesë të konsiderueshme të ekonomisë.

¹ <https://www.cityam.com/how-albania-went-from-europes-socialist-poorhouse-to-a-narco-state/>

Studiuesit vërejnë se ekzistojnë dallime midis llojeve të ndryshme të narkoshteteve. Megjithatë, të gjitha kanë të përbashkëta, në një masë të caktuar, elementet e mëposhtme:

- Dominimi i drogës në sektorë kyç.
- Kapja institucionale (gjyqtarë, deputetë, zyrtarë të lartë, anëtarë të kabinetit qeveritar).
- Varësia nga ndërhyrjet ndërkombëtare kundër drogës.

Këto kritere janë në përputhje me ato të përdorura në literaturën akademike dhe të politikave publike mbi narkoshtetet dhe shtetet e kriminalizuara (p.sh. Shelley, UNODC, GI-TOC). Shqipëria shfaq disa tregues që përputhen me një narkoekonomi, megjithëse matja e saktë mbetet e vështirë.

Nga burime të shumta, vlerësimet e besueshme për të ardhurat e paligjshme të përthithura brenda vendit **variojnë nga 15% deri në 20% të PBB-së, me shifrën prej rreth 4 miliardë eurosh që përsëritet më shpesh²**, ndërkohë që sektorët thelbësorë prodhues si industria dhe bujqësia tkurren për shkak të neglizhencës. Ky është vlerësimi më i ulët që kemi gjetur, ndërsa më i larti është ai i CityAM, i cili shkon deri në gjysmën e PBB-së.

Një reportazh i Sunday Times³ në fillim të vitit 2024 mbi Shqipërinë përmendi se në vitin 2023, 2.85 miliardë euro të investuara në ndërtim nuk kaluan përmes bankave. Edhe nëse do të zbrisnim remitancat, shuma që vjen nga paratë e drogës mbetet e konsiderueshme. Sekuestrimet e mëdha në portet evropiane nënvizojnë shkallën e këtyre rrjeteve, duke përforcuar rrezikun që të ardhurat e paligjshme të deformojnë ndjeshëm ekonominë e brendshme shqiptare.

Nëntë vite më parë, kur problemi kryesor ishte kryesisht kultivimi i kanabisit dhe Shqipëria nuk ishte ende një nyje e madhe për kokainën dhe heroinën, Bashkimi Evropian⁴ vlerësonte se industria e drogës në Shqipëri përbënte 2.6% të PBB-së së vendit. Sipas raportit të progresit të BE-së, të ardhurat e gjeneruara nga tregtia e narkotikëve përbënin një pjesë domethënëse të ekonomisë shqiptare dhe, kur krahasoheshin me vendet e zhvilluara, ishin deri në 300 herë më të larta; në ekonominë perëndimore si Franca, Italia, Gjermania apo Mbretëria e Bashkuar, pesha e industrisë së drogës në prodhimin kombëtar varionte vetëm nga 0.07% deri në 0.19%.

Me një vlerësim prej 2.6% të PBB-së në vitet 2016–2017, ekonomia e drogës në Shqipëri gjeneronte një xhiro të barabartë me të gjithë sektorin e arsimit publik dhe privat ose me të gjithë sektorin e hotelarisë dhe restoranteve të marrë së bashku.

Sipas një raporti të vitit 2025 të Global Initiative against Transnational Organized Crime, vetëm në një ngarkesë të sekuestruar të dërguar drejt Hamburgut nga një bandë shqiptare, kishte kokainë me vlerë midis 1.5 dhe 3.5 miliardë euro, sekuestrimi më i madh i kokainës. Ka edhe grupe të tjera kriminale që veprojnë në Shqipëri dhe dërgojnë kokainë dhe heroinë drejt Evropës me vlerë miliarda euro.⁵

² <https://kohajone.com/kryesore/ndertimi-eshte-sektori-me-i-madh-qe-lan-90-te-parave-e-pista-te-droges/>

³ <https://www.thetimes.com/world/article/how-british-cocaine-users-are-funding-albanias-mini-dubai-9sqknlcks>

⁴ <https://insajderi.com/industria-e-droges-peshe-domethenese-ne-ekonomine-e-shqiperise/>

⁵ <https://globalinitiative.net/analysis/how-have-albanian-networks-come-to-dominate-cocaine-trafficking-to-europe/>

Siç tregoi një studim i fundit i Altax, duke u bazuar në të dhëna kombëtare dhe ndërkombëtare, si raportet e Bankës Botërore, vlerësimet e Global Financial Integrity dhe shifrat e PBB-së vendase, vetëm në Shqipëri, flukset financiare informale dhe të paligjshme së bashku mund të arrijnë deri në 4–5 miliardë dollarë amerikanë, ose gati 20–25% të PBB-së, në varësi të vitit dhe metodologjisë.⁶ dhe nëse supozojmë se 1 miliard euro nga këto flukse informale janë jo-kriminale, remitanca familjare, evazion fiskal, para të vjetra në qarkullim, 4 miliardë eurot e mbetura përfaqësojnë ende një varësi kriminale të jashtëzakonshme.

Altax vlerëson 20–25% të PBB-së në disa vite; sinteza jonë konservative përdor një kufi më të ulët prej rreth 15%, që gjithsesi mbetet i konsiderueshëm dhe i krahasueshëm me narkoshtetet më të konsoliduara në Amerikën Latine.

Megjithëse remitancat arrijnë rreth 1.4 miliardë euro në vit, shumica e tyre hyjnë në Shqipëri përmes kanaleve formale; në maksimum 400–600 milionë euro mund të konsiderohen informale, duke lënë pjesën më të madhe të flukseve informale të shpjegohen nga burime të tjera, shpesh kriminale.

Këto para ndikojnë dhe deformojnë thellësisht ekonominë dhe zgjedhjet në Shqipëri, siç tregoi edhe raporti i OSBE-së.⁷ **Kartelet shqiptarë janë shndërruar në aktorë madhorë në tregtinë botërore të kokainës, ndërsa Shqipëria është bërë një rrugë e re tranziti në Ballkan.**⁸⁹¹⁰

⁶ <https://altax.al/en/product/money-laundering-in-albanian-economy-and-the-region-2025/#:~:text=This%20paper%20is%20conceived%20as,%2C%20governance%2C%20and%20public%20trust.>

⁷ <https://odhr.osce.org/sites/default/files/f/documents/0/c/600028.pdf>

⁸ <https://www.bbc.com/news/articles/cn0w4e4e00jo>

⁹ <https://www.ftm.eu/articles/albanian-mafia-threatens-europe>

¹⁰ <https://www.ispionline.it/en/publication/albanias-key-position-global-drug-trafficking-31834>

KEY TREND 5: Alternative trafficking methods and routes may explain the stable supply of cocaine in Europe.

Traffickers are increasingly shipping liquefied cocaine that is returned to its solid form in clandestine labs across Europe. They are also responding to enhanced security by switching to smaller ports.

Alternative concealment and trafficking methods may partly explain why cocaine availability and prices have remained stable

in European cities. A technique used by traffickers is the use of liquefied cocaine to circumvent traditional detection methods and optimize transport across borders. Although probably still less common than traditional trafficking methods such as 'hide-and-seek' and 'rip on/rip off',²⁶ liquid cocaine is increasingly infiltrating supply chains by enabling seamless concealment.




FIGURE 5 European ports of entry for cocaine.

While usage rates and patterns differ significantly across European nations, cocaine availability has been stable, if not on the rise. For several years it has been the most commonly used illegal drug in Europe after cannabis.¹⁹ Among the 13 countries that have conducted prevalence surveys on consumption habits since 2021, five reported an increase in estimates of cocaine

Research for this report suggests that low retail prices generally correspond to low wholesale prices, particularly in port cities. As illustrated in Figure 4, wholesale and retail prices in Antwerp, Barcelona and Hamburg are lower than those in landlocked cities (Bucharest, Milan). The supply in non-port cities generally

results in a mark-up derived from additional logistical costs and the associated risks of land transportation. In Milan, where most wholesale cocaine is typically supplied by 'Ndrangheta clans in partnership with Albanians, the price of 1kg of cocaine ranges between €33 000 and €40 000. It is sold for €80–€90 a gram, mainly by street dealers of Nigerian and Moroccan origin.

However, additional factors may contribute to the price differences between cities. In the absence of much information on

purity levels and perceived quality, Barcelona's lower price point could be partly attributed to fewer competing traffickers each with their own portion of the market, potentially leading to stable supply channels that allow for more consistent pricing at the wholesale level. Fieldwork in the Spanish city shows that unlike other key entry ports such as Algeciras and Valencia, wholesaling is handled almost entirely by Spanish-speaking transnational groups with links to the Caribbean (Costa Rica and Dominican Republic)²⁴ and South America (Paraguay).²⁷

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Narkotikët thekson se:

“Grupet kriminale të drejtuara nga shqiptarë, në veçanti, kanë luajtur një rol të rëndësishëm dhe gjithnjë e më të sofistikuar në furnizimin e tregjeve ndërkombëtare me droga të paligjshme, duke zgjeruar rrugët e trafikut nga Amerika Latine drejt vendeve të Bashkimit Evropian, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve

¹¹ <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2024/12/Observatory-of-Organized-Crime-in-Europe-European-Drug-Trends-Monitor-Issue-1-GI-TOC-December-2024.v4.pdf>

të Bashkuara, si dhe duke shfrytëzuar aspekte të ekonomisë shqiptare për të ushqyer korrupsionin dhe krimin financiar.”¹²

“Grupet e krimit të organizuar të drejtuara nga shqiptarë luajnë një rol të rëndësishëm në furnizimin e tregjeve ndërkombëtare me kanabis, kokainë dhe heroinë, sipas autoriteteve shqiptare të zbatimit të ligjit. Këto grupe të krimit të organizuar shfaqin nivele gjithnjë e më të larta sofistikimi në krime, komunikime dhe teknika të pastrimit të parave. Ato operojnë në të gjithë Ballkanin, si dhe në Bashkimin Evropian (BE), Shtetet e Bashkuara, Kanada, Amerikën e Jugut, Mbretërinë e Bashkuar, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Turqi. Rrjetet kriminale shqiptare kanë akses të drejtpërdrejtë në prodhimin e kokainës në Amerikën e Jugut dhe në rrjetet e trafikut që sjellin kokainë në Evropë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Ato përdorin ekonominë shqiptare, veçanërisht sektorin e ndërtimit, për të pastruar të ardhurat dhe për të kontribuar në korrupsion. Krimi i dhunshëm në Shqipëri, përfshirë vrasjet me atentat, shpesh lidhet me krimin e organizuar, dhe gjyqtarë, prokurorë, policë, politikanë, gazetarë dhe aktivistë kanë qenë objekt intimidimi. Shqipëria merr pjesë në Koalicionin Global për Adresimin e Kërcënimeve nga Drogat Sintetike, por gjatë kësaj periudhe raportimi autoritetet nuk raportuan sekuestre të fentanilit apo drogave të tjera sintetike në sasi domethënëse. Korrupsioni, sundimi i dobët i ligjit dhe papunësia ushqejnë problemin e trafikut të drogës në Shqipëri.”¹³

ARTE Europe Weekly

Reportazhi i ARTE Europe Weekly ndërtohet rreth një pyetjeje qendrore provokuese:

A po “flirton” Bashkimi Evropian me një narkoshtet duke avancuar procesin e anëtarësimit të Shqipërisë?

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, reportazhi ndërthur tre linja paralele rrëfimi:

- Rritjen e krimit të organizuar shqiptar në Evropë, veçanërisht në trafikun e kokainës
- Lidhjet e pretenduara midis rrjeteve kriminale dhe pushtetit politik në Shqipëri
- Pse BE-ja vazhdon ta përshpejtojë procesin e Shqipërisë, pavarësisht treguesve të korrupsionit

A. Krimi i organizuar shqiptar si kërcënim evropian

Reportazhi pohon se:

- Grupet kriminale shqiptare janë tashmë ndër pesë rrjetet më të rrezikshme në Evropë, duke cituar Europol-in.
- Sekuestrimet e kokainës në BE janë rritur pesëfish brenda një dekade, duke arritur në 419 tonë në vitin 2023.
- Rrjetet shqiptare dominojnë në Belgjikë dhe Holandë (veçanërisht në Portin e Antverpenit), Itali, Spanjë, Gjermani, Francë dhe në Mbretërinë e Bashkuar (e përshkruar si tregu më i madh i kokainës në Evropë).

¹² <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2025/03/2025-International-Narcotics-Control-Strategy-Volume-1-Accessible.pdf>

¹³ <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2025/03/2025-International-Narcotics-Control-Strategy-Volume-1-Accessible.pdf>

Grupet shqiptare paraqiten si jashtëzakonisht profesionale, transnacionale, që operojnë drejtpërdrejt nga vendet e prodhimit në Amerikën Latine. Kjo pjesë e reportazhit është e pasur me fakte dhe mbështetet kryesisht në të dhëna të organeve të zbatimit të ligjit.

B. Nga krimi te politika: kapja e pretenduar e shtetit

Sipas ARTE, paratë kriminale kanë depërtuar në sistemin gjyqësor dhe në qeveri. Zgjedhjet nën kryeministrin Edi Rama paraqiten si të diskutueshme. Autoritetet akuzohen se ose mbyllin sytë, ose mbrojnë aktivisht “ekonominë hije”.

Rastet e përmendura përfshijnë:

- Një takim midis Ramës dhe një përfaqësuesi të kartelit Sinaloa, i akuzuar për pastrim parash përmes një kazinoje, licenca e së cilës u dha nga qeveria shqiptare pas takimit me kryeministrin.
- Rasti i ish-ministrit të Brendshëm (Tahiri).

Mesazhi kryesor këtu është ai i drejtësisë selektive: sinjalizuesit (whistleblowers) dhe oficerët e zbatimit të ligjit ndëshkohen, ndërsa zyrtarët qeveritarë i shpëtojnë përgjegjësisë.

C. Varfëria si faktor strukturor lehtësues

Reportazhi thekson:

- Shqipërinë si një nga vendet më të varfra të Evropës
- 1 në 5 persona nën kufirin e varfërisë
- Papunësi të lartë të rinjtë
- Familje të tëra që bëhen ekonomikisht të varura nga rrjetet kriminale
- Ekonomia e drogës nuk paraqitet si marginale, por si sistematike¹⁴

D. Reforma në drejtësi dhe procesi i vetingut

Edhe pse BE-ja thekson:

- Vetingun e gjyqtarëve
- Agjencitë antikorruption
- Prokuroritë speciale

Reportazhi pretendon se:

- Vetingu mund të jetë politizuar
- Organet e vetingut janë përdorur për të eliminuar:
 - Gjyqtarë jo-miqësorë
 - Rivalë të brendshëm

Sipas këtij këndvështrimi, reforma është shndërruar në një mjet për konsolidimin e pushtetit, dhe jo për forcimin e sundimit të ligjit.

Raporti i Global Organized Crime Index 2025 për Shqipërinë thekson se: “Tregtia e heroinës në Shqipëri është shumë e organizuar, ku vendi shërben si njëkohësisht si nyje tranziti ashtu edhe shpërndarjeje. Grupet kriminale shqiptare luajnë një rol kyç në kontrabandimin e heroinës afgane drejt Evropës përmes rrugës ballkanike. Shqipëria funksionon kryesisht si vend tranzit për heroinën që trafikohet nga Turqia, Irani, Afganistani dhe Pakistani përgjatë rrugës ballkanike drejt Evropës. Pjesa më e madhe e heroinës hyn në Shqipëri në rrugë tokësore përmes Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, ndërsa në të

¹⁴ <https://www.arte.tv/en/videos/112907-145-A/arte-europe-weekly/>

kaluarën policia shqiptare ka zbuluar edhe disa laboratorë të brendshëm për përpunimin e heroinës. Edhe pse konsumi vendas mbetet i kufizuar, trafiku i heroinës gjeneron fitime të konsiderueshme për krimin e organizuar. Përpjekjet e organeve të zbatimit të ligjit kanë sjellë sekuestre periodike; megjithatë, tregu mbetet i qëndrueshëm për shkak të rrjeteve transnacionale të trafikut dhe korrupsionit në radhët e personelit të kontrollit kufitar.

Shqipëria është shfaqur si një aktor kyç në tregtinë evropiane të kokainës, me grupe të krimit të organizuar që lehtësojnë lëvizjen e sasive të mëdha nga Amerika Latine. Porti i Durrësit shërben si një pikë kryesore hyrjeje për këto ngarkesa, të cilat shpesh fshihen brenda konteinerëve të mallrave. Trafikantët shqiptarë mbajnë lidhje të forta me furnitorë në Kolumbi dhe Ekuador, duke u mundësuar atyre të zgjerojnë ndikimin në tregjet evropiane të kokainës. Përveç dërgesave detare, grupet e krimit të organizuar po përdorin gjithnjë e më shumë rrugë tokësore përmes Spanjës dhe Holandës për të shpërndarë kokainë në të gjithë kontinentin. Pavarësisht arrestimeve të rëndësishme dhe sekuestre të drogës, trafiku i kokainës mbetet një aktivitet kriminal i përhapur.

Kanabisi mbetet droga e paligjshme më e përhapur që tregtohet në Shqipëri, me kultivimin vendas që vazhdon pavarësisht goditjeve nga organet e rendit. Kalimi nga kultivimi në ambiente të hapura në kultivim të mbyllur e ka bërë zbulimin më të vështirë, pasi përdoren sera dhe sisteme hidroponike për të mbështetur prodhimin gjatë gjithë vitit. Grupet kriminale shqiptare dominojnë zinxhirët e furnizimit me kanabis në Evropën Perëndimore, veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar dhe Spanjë. Edhe pse Shqipëria legalizoi kanabisin mjekësor në vitin 2023, tregu i paligjshëm vazhdon të ekzistojë, i nxitur nga kërkesa e lartë dhe rrjetet e konsoliduara të trafikut që përdorin platforma komunikimi të enkriptuara për të koordinuar dërgesat.

Tregtia e drogave sintetike, megjithëse më e vogël se tregjet e tjera të drogës, ka shënuar rritje vitet e fundit. Substanca si MDMA, amfetaminat dhe metamfetamina po bëhen gjithnjë e më të përhapura, veçanërisht në jetën e natës urbane dhe zonat turistike. Këto droga sintetike shpesh kontrabandohen nga vendet fqinje, me Shqipërinë që shërben kryesisht si vend destinacioni. Grupet kriminale shqiptare kanë krijuar partneritete me prodhues të bazuar në Holandë dhe në Ballkan për të furnizuar tregjet lokale dhe ndërkombëtare me droga sintetike. Përpjekjet e zbatimit të ligjit janë përqendruar në çmontimin e rrjeteve të shpërndarjes; megjithatë, evoluimi i shpejtë i tregjeve të drogave sintetike vazhdon të rrisë disponueshmërinë dhe paraqet sfida të vazhdueshme për zbulimin.

Rrjetet kriminale shqiptare janë ndër më me ndikim në rajon, duke operuar si brenda vendit ashtu edhe ndërkombëtarisht. Ato përfshihen në një gamë të gjerë aktivitetesh të paligjshme, përfshirë trafikun e drogës, kontrabandën e armëve, vrasjet me pagesë dhe trafikun e qenieve njerëzore. Gjetjet e fundit tregojnë se rrjetet kriminale shqiptare dominojnë tregtinë e kokainës në Evropë, duke ruajtur lidhje të forta me furnitorë në Amerikën Latine. Për më tepër, këto grupe kanë ndërtuar lidhje të thella me organizata kriminale turke dhe kosovare, duke forcuar më tej ndikimin e tyre në tregjet rajonale dhe transnacionale. Dhuna mbetet një tipar i theksuar i rrjeteve kriminale shqiptare, me disa raste vrasjesh me pagesë dhe atentatesh të targetuara të raportuara, veçanërisht në zonat urbane.

Korrupsioni brenda institucioneve politike dhe atyre të zbatimit të ligjit në Shqipëri vazhdon të lehtësojë veprimtarinë e krimit të organizuar. Hetimet që kanë përdorur platforma komunikimi të enkriptuara kanë zbuluar lidhje të thella midis zyrtarëve të lartë dhe aktorëve kriminalë. Disa oficerë policie dhe zyrtarë të sistemit të drejtësisë janë implikuar në ndihmën ndaj rrjeteve kriminale, me disa prej tyre që janë përfshirë

drejtpërdrejt në aktivitete të paligjshme. Përfshirja e aktorëve të integruar në shtet shtrihet edhe në tenderë publikë dhe kontrata qeveritare, ku grupet kriminale përdorin ryshfet dhe shantazh për të siguruar marrëveshje fitimprurëse.

Ndërsa grupet kriminale shqiptare dominojnë peizazhin e krimit të organizuar në vend, aktorë të huaj ruajnë një prani të dukshme, veçanërisht në kontrabandën e qenieve njerëzore dhe trafikun e drogës. Raportet tregojnë se grupe kriminale palestineze, irakiane, iraniane dhe marokene janë aktive në operacionet e kontrabandës së migrantëve. Organizatat kriminale turke kontrollojnë rrugët e trafikut të heroinës drejt Shqipërisë, ndërsa grupet mafioze italiane ruajnë ndikim në jug të Shqipërisë dhe në Tiranë. Për më tepër, bota kriminale ruse është lidhur me organizata kriminale shqiptare, megjithëse bashkëpunimi i tyre duket më i kufizuar krahasuar me rrjetet e tjera të huaja.

Sektori privat në Shqipëri, veçanërisht ndërtimi, pasuritë e paluajtshme dhe industria e lojërave të fatit, luan një rol të rëndësishëm në pastrimin e parave dhe flukset financiare të paligjshme. Organizatat kriminale i shfrytëzojnë këta sektorë për të pastruar të ardhurat nga trafiku i drogës dhe aktivitete të tjera kriminale. Edhe pse qeveria ka vendosur ndalime të pjesshme mbi lojërat e fatit, infiltrimi kriminal mbetet i përhapur, veçanërisht në zonat urbane dhe turistike. Raportet tregojnë se disa biznese në këto zona kanë lidhje të drejtpërdrejta me grupet kriminale, ku hotelet dhe resortet shpesh shërbejnë si fasada për operacione të pastrimit të parave.”¹⁵

Ndërtimi është një sektor me kthim të lartë investimi (15%–25% ROI), prandaj edhe paratë e paligjshme kanalizohen drejt tij, në krahasim me bujqësinë apo industrinë, edhe pse bujqësia është një sektor me vlerë të ulët të shtuar, ndryshe nga sektorët me vlerë të lartë të shtuar si prodhimi. Në vitin 2024, një fakt domethënës është se kredia bankare për ndërtimin përbënte vetëm 22%, duke ngritur pyetjen se si u financua pjesa dërrmuese e ndërtimeve. Sipas të dhënave të bankës qendrore, kreditë e reja për ndërtim arritën në 380 milionë euro dhe kreditë e reja për banesa në 467 milionë euro. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, kreditë e reja për ndërtim dhe banesa arritën gjithsej rreth 847 milionë euro në vitin 2024. **Kur kjo shifër krahasohet me investimin total të vlerësuar në ndërtim, bazuar në lejet e ndërtimit, prodhimin sektorial dhe vlerësimet e tregut, financimi bankar përbën afërsisht vetëm 22% të aktivitetit.**

Ky model është thelbësisht i paqëndrueshëm. Në një skenar ku flukset e paligjshme do të kufizoheshin ndjeshëm, Shqipëria me shumë gjasa do të përballej me një tkurrje të fortë afatshkurtër. Vitet e fundit, administratat amerikane kanë intensifikuar përpjekjet kundër karteleve transnacionale të drogës dhe qeverive që i mundësojnë ato. Po ashtu, Bashkimi Evropian u ka bërë shpesh thirrje të forta qeverive, brenda dhe jashtë BE-së, që të luftojnë aktivitetet kriminale dhe ndikimin e tyre në ekonomi. Nëse ekonomia shqiptare mbahet në këmbë në mënyrë masive nga këto flukse informale apo të paligjshme dhe nga asgjë tjetër, atëherë përballemi me një rrezik të jashtëzakonshëm për ekonominë tonë. Duke marrë parasysh edhe skandalet e tjera të korrupsionit që përfshijnë Zëvendëskryeministren dhe Ministren e Energjisë dhe

¹⁵ https://ocindex.net/assets/downloads/2025/english/ocindex_profile_albania_2025.pdf

Infrastrukturës¹⁶ ¹⁷¹⁸, **skandalin e AKSHI-t**¹⁹²⁰²¹²²²³ dhe **afëra të tjera korrupsioni**²⁴ të zbuluara vitet e fundit, kolapsin e sigurisë kibernetike dhe infiltrimin e kompanive dhe ndikimeve ruse dhe të tjera armiqësore — përfshirë subjekte nën hetim nga NATO — si dhe ndikimin masiv të parave të drogës, problemi nuk është vetëm shqiptar, por edhe i NATO-s dhe i Bashkimit Evropian.

Kjo varësi jo vetëm që minon parimet e lirisë ekonomike dhe sovranitetit kombëtar, por gërryen edhe vetë strukturën e një sistemi tregu të lirë. Rruga e Shqipërisë përpara kërkon reforma vendimtare: ulje të ndjeshme të taksave për të çliruar forcat prodhuese, çmontim të kontrollit të centralizuar shtetëror që mbyt konkurrencën, dhe shpëputje të plotë nga rrjetet kriminale përmes zbatimit rigoroz të ligjit. Pa masa të tilla, iluzioni i progresit do të shembet, duke lënë një vend të ekspozuar ndaj kolapsit.

Raporte të besueshme tregojnë gjithashtu ndikimin e këtij modeli ekonomik mbi demokracinë shqiptare: erozionin e standardeve, mungesën e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, si dhe grumbullimin e pushtetit. Parlamenti Evropian duhet ta kushtëzojë më tej integrimin me këto imperativa, në mënyrë që të nxitet një zhvillim i vërtetë dhe gjithëpërfshirës.

Ekonomia Shqiptare: Karakteristikat, Tiparet dhe Faktorët që e Mbajnë në Këmbë

Peizazhi ekonomik i Shqipërisë, i formësuar nga trashëgimia e saj post-komuniste, nxjerr në pah një vend në udhëkryq: i pozicionuar për integrim në familjen evropiane, por i penguar nga shtrembërime të thella strukturore që favorizojnë përfitime afatshkurtra për pakicën, në dëm të mirëqenies së qëndrueshme për shumicën. Me një Prodhim të Brendshëm Bruto prej 27 miliardë eurosh në vitin 2024, Shqipëria funksionon si një ekonomi e vogël dhe e hapur, fort e varur nga remitancat, ndërtimi dhe shërbimet. Vetëm remitancat kontribuojnë rreth 1.4 miliardë euro në vit, ose rreth 8% të PBB-së (Bilanci i Pagesave, Banka e Shqipërisë, 2024), ndërsa turizmi dhe shërbimet e lidhura me të janë rritur duke përfaqësuar rreth 25% të prodhimit ekonomik (Statistikat e Turizmit, INSTAT, 2024). Megjithatë, INSTAT raporton se edhe ky sektor, i cili ka mbajtur ekonominë vitet e fundit, ka shfaqur një ngadalësim në vitin 2025.

¹⁶ <https://albaniavisit.com/tourism-politics/balluku-corruption-albania-deputy-pm/>

¹⁷ <https://www.balkanweb.com/en/Balluk%27s-immunity-Lubonja%27s-corruption-of-the-deputy-prime-minister-an-unprecedented-crime-is-being-covered-up-by-Rama-the-protests-should-have-been-from-the-people-after-serious-scandals/#gsc.tab=0>

¹⁸ <https://www.voxnews.al/english/politike/nen-hetim-per-11-tendera-me-vlere-11-miliard-euro-bardhi-balluku-po-ble-i109263>

¹⁹ <https://www.hashtag.al/en/index.php/2026/01/19/dosja-akshi-kercenon-jo-vetem-shqiperine-po-shba-ne-e-nato-n-berisha/>

²⁰ <https://www.balkanweb.com/en/Akshi-Tabaku-scandal%3A-half-a-billion-euros-went-to-a-criminal-scheme--not-to-engineers/#gsc.tab=0>

²¹ <https://balkaninsight.com/2025/12/16/eight-accused-in-albania-of-rigging-information-agency-tenders/>

²² <https://www.alfapress.al/english/politike/kikia-afëra-e-akshi-t-skandali-me-i-madh-ne-35-vjet-qe-konfirmoi-lidhje-i184309>

²³ <https://www.kapitali.al/english/lajme-nga-vendi/thellohet-skandali-vellai-gezim-hoxha-i-ambasadorit-shqiptar-ne-i36139>

²⁴ <https://www.voxnews.al/english/fokus/skema-e-skandalit-te-durana-tech-park-si-ishin-pergatitur-biznesment-e-dos-i108064>

Në thelb, ekonomia shqiptare shfaq tipare të qarta brishtësie: nivele të larta emigracioni që rrjedhin kapitalin njerëzor, me gjithsej rreth 1.1 milion persona (afërsisht 40% e popullsisë), sipas EUROSTAT dhe burimeve të tjera, që kanë emigruar që prej vitit 2014 vetëm drejt zonës Shengen, pa llogaritur emigrimin drejt SHBA-së dhe Mbretërisë së Bashkuar. Ndërkohë, produktiviteti ka rënë, me një mesatare prej -1.2% në vit gjatë periudhës 2023–2025 (Llogaritë Kombëtare, INSTAT 2025). Në tremujorin e parë të vitit 2025, nga 362 milionë euro investime të huaja direkte (IHD), 110 milionë euro u përqendruan në sektorin e pasurive të paluajtshme dhe 71 milionë euro në aktivitetin financiar, ndërsa industria dhe energjia shënuan rënie. Pesha e investimeve në pasuri të paluajtshme në totalin e IHD-ve është rritur nga 5.7% në vitin 2014 në 29% në tremujorin e parë të këtij viti, duke treguar se edhe rritja vjetore e investimeve të huaja nuk vjen nga investitorë të mëdhenj në industri konkurruese apo prodhuese.

Në të vërtetë, për të kompensuar shpopullimin e konsiderueshëm dhe mungesën e fuqisë punëtore, politika zyrtare e qeverisë, siç është deklaruar nga vetë Kryeministri në vitin 2021, është sjellja e personave nga Azia dhe Afrika, të cilët në shumicën e rasteve përpiqen të hyjnë ilegalisht në BE, duke krijuar një rrugë të re migratore. Shqiptarët largohen për shkak të kostos së lartë të jetesës, mungesës së mundësive në treg, arsimit dhe shëndetësisë jo cilësore, si dhe problemeve me sundimin e ligjit dhe sigurinë e jetës në rrugë. Ky “brain drain”, nga ana tjetër, është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon negativisht ekonominë dhe tregun e punës. Ndërkohë, për shkak të mungesave në tregun e punës, flukset e paligjshme në valutë të huaj kanalizohen drejt ndërtimit dhe shërbimeve, duke rritur çmimet, ndërsa fuqia blerëse e atyre që mbeten në vend bie.

Një karakteristikë kritike, por shpesh e anashkaluar, është përfshirja e gjerë e qeverisë në treg, e cila centralizon aktivitetin ekonomik dhe mbyt shfaqjen e një tregu të lirë të vërtetë. Në Shqipëri, shteti ushtron një ndikim të rëndë përmes rregulloreve të shumta, subvencioneve dhe ndërhyrjeve të drejtpërdrejta që favorizojnë entitete të lidhura politikisht në dëm të sipërmarrjeve konkurruese. Për shembull, proceset e prokurimit publik shpesh u jepen kompanive me lidhje me elitën në pushtet, siç theksohet në **State Department Investment Climate Statements (2024)**, të cilat evidentojnë korrupsionin e përhapur dhe favorizimin në tenderë.

I njëjti raport thekson se: *“Investitorët e huaj e perceptojnë Shqipërinë si një vend të vështirë për të bërë biznes. Ata citojnë korrupsionin, përfshirë në sektorin publik, sistemin gjyqësor dhe prokurimet publike, konkurrencën e padrejtë dhe të shtrembëruar, ekonominë e madhe informale, pastrimin e parave, ndryshimet e shpeshta të legjislacionit fiskal dhe zbatimin e dobët të kontratave si sfida të vazhdueshme për investimet dhe biznesin në Shqipëri. Emigrimi i fuqisë punëtore të re dhe të kualifikuar ka krijuar mungesa që ndikojnë negativisht perspektivat e investimit. Shqipëria vazhdon të renditet dobët në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International. Në vitin 2023, Shqipëria u rendit e 98-ta nga 180 vende, një përmirësim i lehtë nga viti 2022, por ende larg renditjes së saj më të mirë në vitin 2016, kur ishte e 83-ta nga 176 ekonomi.”*

Shqipëria vuan nga një sektor i madh informal dhe aktivitete të pastrimit të parave. **Financial Action Task Force (FATF)** e përfshiu Shqipërinë në listën gri në vitin 2020. Gjatë viteve 2020–2022, vendi iu nënshtrua katër raporteve vijuese dhe përmirësoi përputhshmërinë teknike, duke rezultuar në heqjen nga lista gri në tetor 2023. Megjithatë, komuniteti i biznesit raporton se fluksi i madh i të ardhurave të paligjshme nga trafiku i drogës, kontrabanda, evazioni fiskal dhe korrupsioni shtrembëron konkurrencën në treg. Akuzat për korrupsion janë të shpeshta dhe investitorët raportojnë se mund të bëhen objekt shantazhi nga administrata publike, media dhe grupet kriminale.

Raportimet për korrupsion në prokurimet qeveritare janë të zakonshme, me investitorë që raportojnë shpesh raste ku korrupsioni qeveritar vonon ose pengon investimet në Shqipëri. Përdorimi i vazhdueshëm i kontratave të Partneritetit Publik-Privat (PPP) ka reduktuar mundësitë për konkurrencë, përfshirë edhe nga investitorët e huaj, në infrastrukturë dhe sektorë të tjerë. Analiza e dobët dhe mungesa e ekspertizës teknike në hartimin dhe monitorimin e kontratave PPP mbeten shqetësime serioze. Disa investitorë amerikanë janë përballur me mosmarrëveshje tregtare të ndërlikuara si me entitete publike ashtu edhe private, disa prej të cilave kanë përfunduar në arbitrazh ndërkombëtar.

Të drejtat e pronës vazhdojnë të jenë një problem në Shqipëri, pasi titujt e qartë të pronësisë janë të vështirë për t'u siguruar. Ka raste ku individë dyshohet se kanë manipuluar sistemin gjyqësor për të përfituar titujt e paligjshëm pronësie. Titujt e mbivendosur të pronës janë një problem i përhapur. Procesi i kompensimit për pronat e konfiskuara nga regjimi komunist mbetet i ngadaltë, joefikas dhe i pamjaftueshëm. Qeveria ka deklaruar vullnet për ta adresuar këtë problem, por progresi ka qenë i ngadalshëm.

Në **Investment Climate Statement 2024** për Shqipërinë, raporti përshkruan “kapjen e shtetit” si një formë korrupsioni sistemik, ku partitë në pushtet ushtrojnë ndikim të padrejtë mbi institucionet shtetërore, duke krijuar një terren të pabarabartë për investitorët. Raporte më të hershme, si ai i vitit 2021, e lidhin gjithashtu kapjen e shtetit me korrupsionin dhe ndërhyrjen politike në drejtësi dhe ekonomi.

State Department Country Reports on Human Rights Practices: Albania (2024), i publikuar në gusht 2025, raporton censurë dhe vetë-censurë të medias, si dhe presion të ushtruar nga qeveria dhe grupet kriminale mbi median dhe gazetarët.

Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian kanë identifikuar në mënyrë eksplicite kapjen e shtetit në Shqipëri në raportet e zgjerimit dhe progresit, shpesh si pjesë e kritikave për prapakthimin demokratik dhe korrupsionin në Ballkanin Perëndimor. Shembuj kyç përfshijnë:

- **Komunikimin e vitit 2018 mbi Perspektivën e Besueshme të Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor**, ku thuhet se vendet e rajonit, përfshirë Shqipërinë, “shfaqin elemente të qarta të kapjes së shtetit, përfshirë lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe administratës”.
- **Komunikimin e vitit 2020 mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së**, që vë në dukje progres të kufizuar në adresimin e kapjes së shtetit në Shqipëri.
- Raportet më të fundit, përfshirë **Komunikimin e vitit 2024 mbi Politikën e Zgjerimit**, që rikonfirmojnë rreziqet e kapjes së shtetit si një sfidë madhore, me referenca specifike për reformat në drejtësi dhe antikorruption.

